

UDHËZIM
Nr. 23, datë 21.11.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E VEPRAVE PENALE QË PËRBËJNË NDALIM PËR TË
PUNUAR NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 60/1, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund të punësohet dhe kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij udhëzimi përbën ndalim për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar dënimi me vendim gjykatë të formës së prerë për veprat penale të parashikuara nga nenet 73, 74, 74/a, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a 79/b, 79/c, 81, 86, 87, 88, 89/a, 99, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108, 108/a, 109, 109/b, 109/c, paragrafi i dytë i nenit 110, 110/a, 110/b 110/c, 111, 113, 114, 117, 124, 124/b, 128/b, 129, 130/a, 135, 136, 139, 140, 141, 186/a, 187, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, 245, 245/1, 259, 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 286, 286/a, 333, 333/a 334 të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu